

Vendim nr. 214, datë 25.06.2026

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Fiona Papajorgji,	Kryetare
Marjana Semini,	Anëtare
Asim Vokshi,	Anëtar

në datën 25.06.2026 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 12 (M) 2026 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

KËRKUESE: **MIRELA GUDA**, përfaqësuar nga avokatja Gentiana Tirana, me prokurë.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2025-4873 (610), datë 17.12.2025 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Lënia në fuqi e vendimeve nr. 797, datë 14.12.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë dhe nr. 396 (20-2017-741), datë 22.09.2017 të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë.

BAZA LIGJORE: Nenet 4, 17, 18, 33, 41, pikat 1 dhe 2, 42, 131, pika 1, shkronja “f”, 134, pika 1, shkronja “i” dhe 142, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 6 dhe 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*) dhe Protokolli nr. 1 i saj; ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*Ligji Organik i Gjykatës*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjo i relatorin e çështjes Asim Vokshi, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Me vendimin nr. 33, datë 19.09.1997 (*vendimi nr.33/1997*), Komisioni për Kthimin dhe Kompensimin e Pronave (KKKP), Gjirokastrë u ka njohur dhe u ka kthyer trashëgimtarëve të ish-pronarëve M.H e vëllazërisë së tij, ndër të cilët shtetasi S.H., një kullotë 15 ha në fshatin Peshkëpi. Po kështu, u ka njohur, bashkë me dy familje të tjera, një kullotë në Hasan Avdi e Levend me sipërfaqe 488 ha duke u kthyer 422 ha, ndërsa për sipërfaqet 55 ha e kthyer në tokë bujqësore dhe 3 ha e zënë nga repartit ushtarak i brigadës së tankeve, ka vendosur kompensimin. Gjithashtu, KKKP-ja, Gjirokastrë u ka njohur në bashkëpronësi me një familje tjetër një kullotë në Tavan Karra, me sipërfaqe 804 ha dhe 12 ha pyll, nga të cilat u ka kthyer 547 ha dhe 12 ha pyll, ndërsa për sipërfaqen 257 ha, të kthyer në tokë bujqësore, ka vendosur kompensimin.

2. Me qëllim regjistrimin e vendimit nr. 33/1997 të KKKP-së, Gjirokastrë, kërkesja, në cilësinë e një prej trashëgimtarëve ligjorë të trashëgimlënësit S.H., është paraqitur pranë Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZVRPP), Gjirokastrë, ku është vënë në dijeni se planvendosja që shoqëron vendimin nuk ka të përcaktuar sipërfaqen 547 ha kullotë dhe 12 ha pyll të kthyera brenda sipërfaqes totale 804 ha. Në vijim, kërkesja i është drejtuar Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave (AKKP), e cila i ka kthyer përgjigje se vendimi objekt gjykimi nuk mund të rishikohet, pasi kjo e drejtë është shfuqizuar me vendimin nr. 43, datë 06.10.2011 (*vendimi nr.43/2011*) të Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*), duke e rekomanduar t'i drejtohet gjykatës për zgjidhjen e çështjes.

3. Në këto kushte, kërkesja i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me kërkesëpadi, me objekt plotësimin e vendimit nr. 33/1997 të KKKP-së, Gjirokastrë, në emër të subjekteve të shpronësuar M.H. e vëllazëri, duke saktësuar e përcaktuar në planvendosjen që shoqëron vendimin sipërfaqen 547 ha kullotë dhe 12 ha pyll të kthyera brenda sipërfaqes totale 804 ha, me kufijtë përkatës. Me vendimin nr. 11569, datë 03.12.2014, Gjykata e Rrethit Gjyqësor

Tiranë ka vendosur shpalljen e moskompetencës tokësore dhe dërgimin e çështjes për gjykim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë. Ky vendim është lënë në fuqi me vendimin nr. 476, datë 26.02.2015 të Gjykatës së Lartë.

4. Me vendimin nr. 21-2015-2034 (776), datë 09.12.2015, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë ka vendosur pranimin e padisë dhe plotësimin e vendimit nr. 33/1997 të KKKP-së, Gjirokastrë, duke përcaktuar pozicionin topografik, zonat kadastrale dhe kufizimet e sipërfaqes së hartës që shoqëron vendimin e të KKKP-së, Gjirokastrë sipas hartës topografike të ekspertit të caktuar nga ajo gjykatë. Mbi ankimin e AKKP-së dhe Avokaturës së Shtetit, me vendimin nr.141, datë 09.03.2016, Gjykata e Apelit Gjirokastrë ka vendosur prishjen e vendimit të shkallës së parë dhe kthimin e çështjes për rigjykim me tjetër trup gjykues, duke lënë si detyrë për gjykatën e shkallës së parë hetimin gjatë rigjykimit të situatës juridike të pronës në atë moment në raport me posedimin e saj nga të tretët, si dhe a është ky posedim i ligjshëm, në zbatim të ligjit nr. 7501, datë 19.07.1991 “Për tokën”, të ndryshuar (*ligji nr.7501/1991*).

5. Në rigjykim, me vendimin nr. 797, datë 14.12.2016, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë ka vendosur pranimin e padisë, plotësimin e vendimit nr. 33/1997 të KKKP-së, Gjirokastrë, duke përcaktuar pozicionin topografik për njohjen e sipërfaqes 804 ha kullotë dhe 12 ha pyll, me sipërfaqe të kthyer 547 ha, si dhe përcaktimin e vendndodhjes dhe kufizimeve të kësaj pasurie me aktin e ekspertimit që është pjesë përbërëse e vendimit të shkallës së parë. Ajo gjykatë ka arsyetuar se në zbatim të detyrave të lëna nga gjykata e apelit ka bërë pjesë të fashikullit gjyqësor vendimmarrjet e gjykatave, ku Këshilli i Rrethit Gjirokastrë kishte kundërshtuar gjyqësish vendimin nr. 33/1997 të KKKP-së, Gjirokastrë, por se me vendimin nr. 689, datë 09.11.1999 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë ka vendosur pushimin e gjykimit të çështjes, ky i fundit më pas është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Gjirokastrë me vendimin nr. 23, datë 19.01.2000. Në vijim, është ngritur sërish padi nga Këshilli i Rrethit Gjirokastrë, por, me vendimin nr. 130, datë 27.02.2001 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, është vendosur pushimi i gjykimit të çështjes dhe vendimi ka marrë formë të prerë pa u ankimuar. Po kështu, sipas gjykatës së shkallës së parë, duke vlerësuar aktin e ekspertimit në raport me provat e tjera të administruara, është vlerësuar se është i rregullt, pasqyron qartë vendndodhjen e pronave dhe gjendjen e tyre juridike, si dhe provon se nuk krijohet mbivendosje me pasuri të tjera të regjistruara në emër të

pronarëve të tjerë. Kundër këtij vendimi kanë paraqitur ankim pala e paditur, ATP-ja dhe Avokatura e Shtetit.

6. Me vendimin nr. 369 (20-2017-741), datë 22.09.2017, Gjykata e Apelit Gjirokastrë ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të shkallës së parë, me arsyetimin se kjo e fundit, në përputhje me nenin 467 të Kodit të Procedurës Civile (KPC), ka realizuar të gjitha detyrat e lëna nga gjykata e apelit, duke thirrur si palë të tretë Këshillin e Qarkut Gjirokastrë dhe duke hetuar në lidhje me gjendjen juridike të pronës. Sipas gjykatës së apelit, nga hetimi gjyqësor, me të drejtë, është kryer një akt i ri ekspertimi, pasi toka e pretenduar nga kërkuesja ishte tashmë e regjistruar në ZVRPP-në, Gjirokastrë, duke pasur të gjitha të dhënat e nevojshme për gjendjen e saj dhe titujt e pronësisë të regjistruar mbi të. Po kështu, sipas gjykatës së apelit, në përputhje me vullnetin e KKKP-së, të shprehur në vendimin nr. 33/1997 të KKKP-së, Gjirokastrë, si dhe duke përcaktuar hartën dhe gjendjen faktike të pronës, ajo gjykatë ka përcaktuar saktë sipërfaqen përkatëse. Sipas gjykatës së apelit, Gjykata e Lartë, bazuar në vendimin e saj unifikues nr. 4/2013, si dhe në vendimin nr. 1, datë 16.1.2017 (*vendimi nr.1/2017*) të Gjykatës Kushtetuese (Gjykata), ka vlerësuar se vendimet e KKKP-së dhe të ATP-së nuk janë akte administrative, por akte me natyrë *quasi-gjyqësore* dhe kundërshtohen në rrugën normale gjyqësore, jo si akte administrative, për pasojë nuk mund të zbatohet neni 328 i KPC-së, në fuqi në kohën e dhënies së vendimit nr. 33/1997 të KKKP-së Gjirokastrë. Sipas gjykatës së apelit, për sa kohë neni 27/a i ligji nr. 7698, datë 15.4.1993 “Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve” (*ligji nr. 7698/1993*) nuk parashikon afat ankimi në gjykatë kundër vendimit të dhënë nga KKKP-ja, vendimet e kësaj të fundit të dhëna në bazë të këtij ligji mund të kundërshtohen në çdo kohë, pa u kufizuar në një afat konkret. Po kështu, lidhur me pretendimin e ATP-së se nuk janë marrë në konsideratë parashikimet e ligjit nr. 133, datë 05.12.2015 “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave” (*ligji nr. 133/2015*), gjykata e apelit ka vlerësuar se në pikat 2 dhe 3 të nenit 3 të këtij ligji është përcaktuar se ATP-ja ka kompetencë të trajtojë vendimet e KKKP-së vetëm për sa i përket vlerësimit financiar dhe në funksion të këtij vlerësimi ka të drejtë të kompensojë pronën e njohur dhe të korrigjojë pasaktësi në vendimet e KKKP-së, por vetëm për efekt të kompensimit dhe jo për rastet kur është disponuar kthim fizik i pronës. Sipas arsyetimit të gjykatës së apelit, me vendimin nr. 1/2017, Gjykata ka shfuqizuar dispozitat e ligjit nr. 133/2015 që i jepnin të drejtë ATP-së të ndryshonte vendimet e KKKP-së dhe të ish-AKKP-së që kishin marrë formë të prerë, për sa i

përket kthimit fizik të pronës, për rrjedhojë vendimet e KKKP-së që kanë disponuar kthim fizik nuk mund të ndryshohen nga ATP-ja edhe pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 133/2015 dhe kanë vetëm një rrugë kundërshtimi, atë gjyqësore. Lidhur me pretendimin e ATP-së për mosmarrje dijeni për aktin e ekspertimit, gjykata e apelit ka vlerësuar se pala e paditur ka marrë dijeni rregullisht për gjykimin dhe me vullnetin e saj ka zgjedhur të mos paraqitet në seancë, duke mos ushtruar të drejtat procedurale që i garanton ligji. Për sa i përket pretendimit të Avokaturës së Shtetit se paditësja nuk ka ezauruar rrugën administrative, gjykata e apelit ka arsyetuar se për plotësimin me hartë të kthimit fizik të vendimit nr. 33/1997, kërkuesja paditëse i është drejtuar ish-AKKP-së, e cila, me shkresën e datës 18.02.2014, i ka kthyer përgjigje se nuk ka kompetencë për rishikimin e vendimit objekt gjykimi, pasi kjo e drejtë i është shfuqizuar me vendimin nr. 43/2011 të Gjykatës, duke e rekomanduar t'i drejtohet gjykatës për zgjidhjen e çështjes. Kundër këtij vendimi kanë ushtruar rekurs ATP-ja dhe Avokatura e Shtetit, të cilat kanë ngritur të njëjtat pretendime si në ankim.

7. Me vendimin nr. 00-2025-4873 (610), datë 17.12.2025, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë (në shumicë) ka vendosur prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, me tjetër trup gjykues. Sipas Gjykatës së Lartë, në kuptim të frymës së ligjit nr. 7698/1993, mbi bazën e të cilit është nxjerrë vendimi i ish-KKKP-së, Gjirokastër, dhe jurisprudencës konstante të Gjykatës së Lartë në këtë drejtim, aktet ligjore drejtuar ish-pronarëve ose trashëgimtarëve të tyre nuk përfaqësojnë një mënyrë të re të fitimit të pronësisë, por mjete që garantojnë dhe mbrojnë në themel të drejtën e tyre të pronësisë dhe e bëjnë efektive atë. Gjykata e Lartë, nga ana tjetër, ka arsyetuar se me vendimin nr. 27, datë 26.5.2010 Gjykata ka vendosur të shfuqizojë nenin 16 të ligjit nr. 9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës” (ligji nr. 9235/2004), duke vlerësuar se vendimet e organeve administrative, që kanë pasur si kompetencë kthimin dhe kompensimin e pronave, nuk janë akte administrative, por janë akte *quasi gjyqësore*, ndaj mjeti i duhur për plotësimin e këtyre akteve, mund të adresohet në rrugë gjyqësore e për pasojë pretendimet e rekursuesve për parashkrimin e afatit 30-ditor të ankimit ndaj vendimit të ish-KKKP-së janë të pabazuara. Po kështu, ajo gjykatë ka vlerësuar se edhe ligji nr.133/2015, në nenin 16, pika 3, të tij, ka parashikuar që në rast se vendimet administrative kanë të meta teknike/hartografike ose gabime materiale të dukshme, me kërkesë të subjektit, ATP-ja mund të bëjë plotësimin e të metës ose ndreqjen e

gabimit, pa prekur përmbajtjen e vendimit, sipas përcaktimeve të KPC-së, duke iu referuar gabimeve të vendimeve të dhëna nga vetë ATP-ja si një organ administrativ publik dhe akteve të cilat për efekt të përmbylljes së procesit të kompensimit të pronës mund të realizoheshin më shpejt dhe në mënyrë më efektive nga ana e autoritetit që i ka nxjerrë ato. Lidhur me kërkimet e padisë dhe vendimet e gjykatave të faktit, Gjykata e Lartë ka arsyetuar se ndonëse vendimi nr. 33/1997 i ish-KKKP-së, Gjirokastrë i është nënshtruar shqyrtimit gjyqësor mbi bazën e padisë së paraqitur nga kërkuesja paditëse, e cila ka pasur për objekt plotësimin e këtij vendimi, hetimi gjyqësor i kryer nga gjykatat e faktit në këtë drejtim nuk ka qenë i plotë dhe shfaq mangësi. Sipas asaj gjykate, nga analiza e vendimmarrjeve gjyqësore ka rezultuar se hetimi është fokusuar kryesisht në verifikimin e pronës së kthyer ish-pronarit trashëgimlënës, në funksion të saktësimit të planvendosjes së saj, ndërkohë që nuk është zhvilluar një hetim i plotë dhe i gjithanshëm mbi përputhshmërinë e konfigurimit aktual të kësaj prone me të drejtat e njohura dhe të kthyerat familjeve të tjera, bashkëpronare sipas vendimit nr. 33/1997 të ish-KKKP-së, Gjirokastrë. Për pasojë, Gjykata e Lartë ka vlerësuar se në të tilla kushte, kur vendimi nr. 33/1997 i ish-KKKP-së është plotësuar nga vendimmarrjet e gjykatave, duke u përcaktuar pozicioni topografik për njohjen e një sipërfaqeje totale prej 804 ha kullotë dhe 12 ha pyll, me kthim fizik 547 ha, është e domosdoshme të evitohet çdo dyshim lidhur me cenimin e të drejtave të familjeve të tjera, për shkak të mospërputhjes së mundshme të këtij pozicionimi me kufijtë dhe masën e sipërfaqeve të përcaktuara në vendimin e ish-KKP-së. Sipas Gjykatës së Lartë, në ndryshim nga dy gjykatat më të ulëta, ajo ka për objekt vetëm kontrollin e zbatimit të ligjit material e procedural nga ana e tyre dhe nuk mund të përsërisë vetë tërësisht ose pjesërisht hetimin gjyqësor, pasi, si gjykatë ligji, nuk mund të marrë prova të reja ose të lejojë palët të debatojnë mbi provat, duke hetuar e çmuar ndryshe provat e debatuar në gjykimin në apel dhe në shkallë të parë, për rrjedhojë i ka lënë disa detyra gjykatës së apelit në rigjykim: (i) verifikimin e subjekteve përfituese të vendimit nr. 33/1997 të ish-KKKP-së, Gjirokastrë dhe pozicionin juridik të bashkëpronarëve, si dhe mënyrën e përfaqësimit të të drejtave të tyre në proces, në raport me kërkimin për saktësimin e planvendosjes së vendimit nr. 33/1997; (ii) administrimin dhe analizimin e dokumentacionit të nevojshëm që provon të drejtat e pronësisë dhe vlerësimin nëse krijohen potencialisht mbivendosje me prona të tjera; (iii) kryerjen e një hetimi të plotë mbi planvendosjen e vendimit nr. 33/1997, nëse pozicioni topografik i sipërfaqeve 547 ha kullotë dhe 12 ha pyll është në përputhje me kufijtë, përshkrimet

dhe masën e sipërfaqeve të përcaktuara në vet vendimin e ish-KKKP-së në raport me të gjithë bashkëpronarët e tjerë; (iv) shqyrtimin e ndikimit të kërkesëpadive paralele të ngritura ndër vite kundër vendimit nr. 33/1997 (për rishikim, anulim ose kundërshtim të kufijve) dhe paqartësive mbi kufijtë dhe mbivendosjet e mundshme, si dhe vlerësimin nëse këto elemente imponojnë nevojën për një verifikim më të thelluar të individualizimit të pronës në terren dhe në dokumentacionin kadastral; (v) vlerësimin e përputhshmërisë së konfigurimit aktual të pronës të saktësuar nga ekspertimi gjyqësor me të drejtat e njohura dhe të kthyerat subjekteve të ndryshme nga vendimi nr. 33/1997, me qëllim evitimin e çdo dyshimi për cenimin ose mbivendosjen e të drejtave të pronësisë së palëve të treta; (vi) zhvillimin e një hetim të plotë dhe të gjithanshëm gjyqësor, në përputhje me nenin 14 të KPC-së, duke lejuar administrimin dhe ballafaqimin e të gjitha provave të nevojshme (dokumentare, hartografike e kadastrale), si dhe duke dhënë një arsyetim të plotë e të qartë mbi çdo element që ndikon në zbatueshmërinë dhe efektivitetin e vendimit nr. 33/1997 të KKKP-së.

8. Në datën 17.04.2026 kërkesja i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual, sipas objektit të tij.

II

Pretendimet e kërkuases

9. **Kërkesja**, në mënyrë të përmblodhur, ka pretenduar se i është cenuar:

9.1. *E drejta për një proces të rregullt ligjor*, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të:

9.1.1. *Së drejtës së aksesit në gjykatë*, pasi kërkesja nuk është njoftuar për të paraqitur parashtrimet e saj para Gjykatës së Lartë, sikurse ndodh kur vihen në diskutim çështje të ligjit, përkundrazi gjykimi është bërë në dhomën e këshillimit, duke lënë detyra për gjykatën e apelit për çështje të cilat as nuk janë trajtuar më parë nga gjykatat më të ulëta dhe as nuk janë ngritur nga pala kundërshtare në ankim ose në rekursin e saj.

9.1.2. *Së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj*, pasi Gjykata e Lartë ka tejkaluar kufijtë e shqyrtimit gjyqësor të përcaktuar nëpërmjet rekurseve të palës së paditur dhe Avokaturës së Shtetit, duke ushtruar kontrollin gjyqësor jashtë rasteve

të lejuara shprehimisht me ligj. Gjykata e Lartë nuk ka arsyetuar mbi shkeljet e ligjit material e procedural të kryera nga gjykata e apelit që i mundësojnë asaj aktivizimin e kompetencës të të vepruarit kryesisht për çështjet e parashtruara si shkak për prishjen e vendimit të gjykatës së apelit.

9.1.3. *Parimit të sigurisë juridike*, pasi vendimi i gjykatës së apelit ka fuqinë jo vetëm të një vendimi të formës së prerë me natyrë ekzekutive, por edhe të një vendimi me natyrë përfundimtare për çështje që i përkasin vlerësimit të provave për atë kohë sa palët nuk kanë ngritur asnjë pretendim për shkelje të ligjit material e procedural nga gjykatat e faktit lidhur me vlerësimin e provave. Nisur nga shkaqet e rekurseve të paraqitura dhe nga kufijtë e shqyrtimit në Gjykatën e Lartë, kërkuësja, në cilësinë e paditëses, ka krijuar pritshmëri të ligjshme për të drejtat e fituara me vendimin e gjykatës së apelit. Gjykata e Lartë, me shumicë votash, ka prishur vendimin e gjykatës së apelit dhe e ka kthyer për rigjykim në atë gjykatë për çështje të mbivendosjes së pronave me të tretë, legjitimitetin substancial të kërkueses dhe ekzistencën e padive të mëparshme, që nuk janë vënë në diskutim nga asnjë prej palëve në gjykim. Vendimi nr. 33/1997 i KKKP-së, Gjyrokastër në themel nuk është objekt i proceseve gjyqësore për atë që është vendosur në të, për njohjen dhe kthimin e pronës, por për mirëpërcaktimin e saj në planvendosje. Verifikimi i gjendjes juridike të kësaj prone është bërë nga gjykata e shkallës së parë 10 vjet më herët dhe nuk kanë rezultuar mbivendosje ose të drejta pronësie të të tretëve, pasi gjendja e saj juridike ka rezultuar me pronësi shtet.

9.1.4. *Parimit të barazisë para ligjit*, pasi Gjykata e Lartë në çështje të njëjta ka mbajtur qëndrime të ndryshme.

9.1.5. *Standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor*, pasi Gjykata e Lartë, ndonëse ka reflektuar në përmbajtje të vendimit të saj se nuk ka gjetur shkelje ligjore nga gjykatat e faktit lidhur me çështjet e ngritura nga pala e paditur dhe Avokatura e Shtetit, nuk ka vendosur mospranim të rekursit. Po kështu Gjykata e Lartë, nga njëra anë, pranon se vendimi nr. 33/1997 është një vendim *quasi gjyqësor* që ka marrë formë të prerë, nga ana tjetër, lë detyra për administrim dhe analizim të dokumentacionit të pronësisë, i cili është administruar e analizuar nga gjykatat e

faktit dhe vlerësimi i provave mbetet bindje e brendshme e gjykatave të faktit dhe jo kompetencë e Gjykatës së Lartë.

- 9.2. *E drejta e pronës private*, e garantuar nga neni 41 i Kushtetutës, pasi edhe pse titulli i pronësisë nuk është vënë në diskutim, Gjykata e Lartë e ka kthyer çështjen për rigjykim në gjykatën e apelit, ndonëse kërkitimi i saj ka të bëjë vetëm me plotësimin e vendimit nr.33/1997 me planvendosje.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimimin e kërkuesses

10. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë edhe kriteret kumulative të nenit 71/a të Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

11. Kërkuessa, si bartëse e të drejtave dhe lirive themelore të parashikuara në Kushtetutë, legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “f”, 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, sepse ka qenë palë në procesin gjyqësor në të cilin është dhënë vendimi gjyqësor i kundërshtuar prej saj, ndaj ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

12. Në lidhje me kriterin e shterimit të mjeteve juridike efektive, sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, individi mund t’i drejtohet Gjykatës me ankim kushtetues individual vetëm pasi të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese që ai pretendon se i janë cenuar. Shterimi i mjeteve juridike ka të bëjë me kontrollin subsidiar që ushtron Gjykata, përfshirë edhe rastet e shkeljes të të drejtave të individit (*shih vendimet nr. 14, datë 21.06.2022; nr. 19, datë 07.07.2021; nr. 14, datë 11.03.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

13. Po kështu, Gjykata ka theksuar se bëhen objekt ankimi ato çështje gjyqësore të paraqitura nga individët për shkeljen e të drejtave të tyre, pasi vendimi i gjykatës ka marrë formë të prerë dhe nuk ekzistojnë më mjete dhe rrugë ligjore për mbrojtjen e këtyre të drejtave. Përndryshe, i njëjti individ do të mund t'i drejtohej Gjykatës disa herë brenda të njëjtit proces gjyqësor, veçmas për çdo pretendim, për cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, në çdo fazë, si dhe në çdo shkallë të tij dhe më pas, pas përfundimit të procesit gjyqësor dhe dhënies së një vendimi përfundimtar, edhe për pretendime të tjera që lidhen me të njëjtin proces gjyqësor. Vetëm pasi individët të kenë konsumuar edhe shkallën e fundit të kontrollit gjyqësor të zakonshëm, këto vendime mund të kontrollohen nga Gjykata nga pikëpamja e kushtetutshmërisë së tyre, për të gjitha pretendimet në tërësinë e tyre (*shih vendimet nr. 38, datë 25.04.2017; nr. 16, datë 10.03.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Duke iu kthyer çështjes në shqyrtim, Kolegji vëren se objekt i ankimit kushtetues individual është shfuqizimi i vendimit të Gjykatës së Lartë, i cili ka vendosur prishjen e vendimit të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, me tjetër trup gjykues, ndërsa në përmbajtje të ankimit ngrihen pretendime për cenimin e procesit të rregullt ligjor lidhur me të drejtën e aksesit, të drejtën për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj, parimin e sigurisë juridike, parimin e barazisë para ligjit dhe standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor, si dhe të drejtën e pronës.

15. Bazuar në standardet e mësipërme kushtetuese, në kushtet kur çështja është kthyer për rigjykim në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm dhe ajo nuk ka marrë një përgjigje përfundimtare nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja "f", të Kushtetutës, Kolegji vlerëson se kërkesja ka ende mjete ligjore efektive në dispozicion për të mbrojtur të drejtat e saj kushtetuese të pretenduara si të cenuara (*të drejtën për një proces të rregullt ligjor në drejtim të së drejtës së aksesit, së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj, parimit të sigurisë juridike, parimit të barazisë para ligjit dhe standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor, si dhe të drejtën e pronës*), përfshirë më pas edhe mbrojtjen kushtetuese në këtë Gjykatë. Për rrjedhojë, në rastin konkret, ankimi kushtetues individual i kërkuar nuk plotëson kriterin paraprak të shterimit të të gjitha mjeteve juridike efektive në dispozicion përpara se t'i drejtohet Gjykatës. Në këto kushte, analiza e përmbushjes së kriterëve të tjera të pranueshmërisë

së ankimit kushtetues individual të kërkueses bëhet e panevojshme, për shkak të karakterit kumulativ të tyre.

16. Në përfundim, Kolegji çmon se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për pranimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pikat 1 dhe 2, shkronja “d”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.